

P. nr.801/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me praktikanten e kësaj gjykate Kaltrina Halilaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. E. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.1544/17 të dt.22.11.2017 ,në shqyrtimin e dytë, të mbajtur më datë **13.09.2018**, në prani të Prokurorit së shtetit Bajram Kryeziu dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. E.** nga Gjakova,Rr. ".....", data e lindjes ne Gjakovë , i biri i N. dhe i nënës N. e gjinisë V. ,ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë ,i martuar , atë i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, ID

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- me datë të pavërtetuar e gjerë me dt. 24.05.2017, në shtëpinë e tij e cila ndodhet në Gjakovë rr. "...", me qëllim që vetës t'i sjellë përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën 61 të Ligjit për Energji Elektrike me nr. 5/L-085, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ashtu që ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, me c'rast ndërmarrjes së dëmtuar- divizioni Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumën prej 75.82 €.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,7,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73 ,neni 320 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit ia shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **2(dy) muajve** dhe dënim me gjobë ne **shumë prej 100.00 (njëqind) euro**, të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E demtuara – distrikti në Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1544/2017 të dt.22.11.2017,e ka akuzuar të akuzuarin F. E. nga Gjakova, për shkak të veprës penale shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë nga neni 61 par. 1 pika 1.1 i Ligjit për Energji Elektrike.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu , në shqyrtimin fillestar me dt.08.05.2018, lexon aktakuzën 1544/17 të dt.22.11.2017,me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por bene rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike nga neni 61/1-1.1 te LEE nr. 05/L85 ne veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-ës.

I akuzuari F. E. , gjate shqyrtimin dytë duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion edhe gjate këtij shqyrtimi gjyqësor deklaroi se ne këtë fazë te procedurës edhe pse ne atë shtëpi në të cilën pretendohet se është kryer keqpërdorimi kanë jetuar edhe anëtarët tjerë te familjes pas vdekjes se prindit ne emër te cilët është njehsori N. E. ,e pranoi ne tërësi fajësinë për veprë penale me te cilën akuzohem duke i ditur edhe me para pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, i propozoi Gjykatës që me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike pasi qe jam i pa punë dhe jetojë me familjen prej 5 anëtarësh ku asnjëri nga ata nuk është ne punë, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet ,fakti se asnjëherë me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit e dëmtuara të udhëzohet në kontest civil.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari F. E. : me datë të pavërtetuar e gjerë me dt. 24.05.2017, në shtëpinë e tij e cila ndodhet në Gjakovë rr. “...”, me qëllim që vetës t’i sjellë përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshëm, në kundërshtim me dispozitën 61 të Ligjit për Energji Elektrike me nr.5/L-085, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ashtu që ka pamundësuar kështu regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar - divizioni Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumën prej 75.82 €.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si në dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimin ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimin. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është i pa punë dhe jeton me familjen prej 5 anëtarësh ku asnjëri nga ata nuk është në punë, i gjendjes së dobët ekonomike, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim ,pendimin e tij dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej veprat e tilla , si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar,

të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg ne kohëzgjatje prej 2(dy) muajve dhe dënim me gjobë prej 100.00 (njëqind) euro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1(një) viti te mos kryej ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr. 801/17 më datë 13.09.2018**

**Procesmbjatësja,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.